



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË SHKODËR

Nr. 6808/12 Prot.

Shkodër, më 25.10.2021

Lënda: Kthim-përgjigje shkresës suaj nr. 126/21 të dërguar në rrugë elektronike.

QENDRES "RES PUBLICA"
(Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7)

Tiranë

Në mbështetje të shkresës suaj të dërguar në rrugë elektronike, përkatësisht në adresën elektronike të identifikuar si entela.celepija@asp.gov.al, nëpërmjet së cilës kërkon informacion në lidhje me numrin e kërkesave/kallëzimeve për lëshim të menjëhershëm të urdhrit të mbrojtjes, si dhe numrin e denoncimeve për veprën penale dhunë në familje, që përfshin periudhën kohore 2015-2021, ju bëjmë me dije se:

Referuar përmbajtjes së regjistrave elektronikë, të cilat disponohen nga strukturat policore përgjegjëse të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, rezultojnë të administruara të dhënat e poshtëshënuara të paraqitura në mënyrë kronologjike dhe shterruese, sipas formatit tabelar, duke pasqyruar informacionin referues objekt të kërkesës suaj:

Periudha vjetore	Numri i kallëzimeve/kërkesave për lëshim urdhër mbrojtjeje	Numri i denoncimeve për dhunë në familje
2015-2016	59	62
2016-2017	73	66
2017-2018	89	70
2018-2019	101	69
2019-2020	83	57
2020-2021	106	72
2021-	116	47

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI
Drejtues Hamdi FJORA